

Anketa për gjuhën

Në Masaçusets fliten shumë gjuhë të ndryshme. Kjo anketë për gjuhën na ndihmon të kuptojmë më mirë aftësitë e fëmijës suaj në anglisht, në mënyrë që t'i ofrojmë mbështetjen e duhur për ta ndihmuar të mësojë këtë gjuhë, nëse është e nevojshme. Përgjigjuni pyetjeve më poshtë. Nëse përgjigjja juaj për ndonjë nga pyetjet në SEKSIONIN 1 është në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, distrikti shkollor do t'i japë fëmijës suaj një test për të parë nëse ai mund të përfitojë nga mbështetja për gjuhën angleze.

Nëse keni nevojë për ndihmë për të plotësuar këtë formular, kërkoni ndihmë.

Emri i nxënësit:

Klasa:

Datëlindja (dd/mm/vvvv):

Emri i prindit/kujdestarit nr. 1:

Emri i prindit/kujdestarit nr. 2:

SEKSIONI 1:

Këto pyetje do ta ndihmojnë shkollën të identifikojë nxënësit që mund të kenë nevojë për mbështetje për gjuhën angleze. Nëse përgjigjja juaj për ndonjë nga pyetjet 1-3 është në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, fëmija do të testohet për përdorimin dhe kuptimin e anglishtes për të përcaktuar nëse nevojitet mbështetje në gjuhën angleze.

1. Renditni gjuhën/gjuhët që përdorin prindërit dhe/ose kujdestarët kryesorë për të komunikuar me fëmijën tuaj në shtëpi.

2. Renditni gjuhën/gjuhët që fëmija juaj përdor aktualisht për të komunikuar me të tjerët.

3. Renditni gjuhën/gjuhët që fëmija juaj i kuptoi dhe i përdori për herë të parë për të komunikuar.

SEKSIONI 2: Shërbime interpretimi dhe përkthimi

Ky seksion do ta njoftojë shkollën nëse ju, prindërit/kujdestarët, keni nevojë për një përkthyes ose dokumente të përkthyer.

Ky seksion është vetëm për qëllime informative dhe nuk përdoret për të identifikuar nëse fëmija juaj ka nevojë për mbështetje për të mësuar anglisht.

4. Në cilën/cilat gjuhë do të preferonte familja juaj të merrte komunikim me shkrim nga shkolla?

Prindi/kujdestari nr. 1:

Prindi/kujdestari nr. 2:

5. A do të preferonit që shkolla të vendoste në dispozicionin tuaj një përkthyes falas gjatë takimeve dhe telefonatave me shkollën për fëmijën tuaj (duke përfshirë gjuhën amerikane të shenjave ose lloje të tjera të gjuhës së shenjave)?

_____ Po _____ Jo

Nëse po, në cilën gjuhë?

Prindi/kujdestari nr. 1: _____

Prindi/kujdestari nr. 2: _____

SEKSIONI 3 [Opsional]: Arsimi paraprak

Ky seksion do t'i ofrojë shkollës informacion mbi nxënësin tuaj dhe arsimin e tij të mëparshëm.

Ky seksion është opsional dhe nuk përdoret për të identifikuar nëse fëmija juaj ka nevojë për mbështetje për të mësuar anglisht.

6. Renditni emrin dhe vendndodhjen e shkollës së fundit që ka ndjekur fëmija juaj.

Emri i shkollës: _____

Qyteti: _____ Shteti: _____

7. Sa vite ka ndjekur fëmija juaj shkollën në Shtetet e Bashkuara? (duke filluar me kopshtin)

_____ Shënoni datën kur fëmija juaj filloi shkollën për herë të parë në Shtetet e Bashkuara, nëse e dini (mm/vvvv): _____

8. A ka ndjekur ndonjëherë fëmija juaj shkollë jashtë Shteteve të Bashkuara?

_____ Po _____ Jo _____ Nuk jam i sigurt

Nëse po, për sa vite? _____ Në çfarë gjuhe/gjuhësh ka mësuar fëmija juaj ndërsa ndiqte shkollën jashtë Shteteve të Bashkuara? _____

Cila është klasa e fundit në të cilën është regjistruar ose ka përfunduar fëmija juaj? _____

9. A ka marrë ndonjëherë fëmija juaj mbështetje për të përmirësuar anglishten e tij në shkollate Shteteve të Bashkuara?

_____ Po _____ Jo _____ Nuk jam i sigurt

10. A ka ndonjë gjë tjetër që mendoni se është e rëndësishme që shkolla ta dijë për fëmijën tuaj? (për shembull, interesa të veçanta, talente ose shqetësime që keni në lidhje me përvojën e fëmijës suaj në shkollë?)

Emri i prindit/kujdestarit: _____

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: _____

Data (dd/mm/vvvv): _____

